



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DITARI MUJOR MARS 2024

Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional, filloj trajnimi i 4 mijë mësuesve

Me trajnimin e mësuesve nga shkollat e Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Tropojës nisi Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025. Deri në fund të vitit 2024, më shumë se 4000 mësues nga i gjithë vendi do të përfitojnë nga trajnimet në lëndët e gjuhës shqipe, matematikës, lëndët e shkencave, arsimit fillor dhe teknologji informacioni. Deri në fund të vitit 2025 kjo shifër do të shkojë në 16 mijë. Ky program, i cili synon rritjen e cilësisë në sistemin tonë arsimor parauniversitar, ka përfshirë si partnerë kryesorë 7 universitete publike të vendit, me një traditë dhe përvojë të pasur në formimin e brezave të rinj të mësuesve, si Universiteti i Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Korçës, Vlorës, Gjirokastrës dhe Shkodrës.



Investimi, studentët e inxhinierisë dhe arkitekturës me një kampus të ri



Një investim madhor prej 1,2 miliardë lekësh ka nisur në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetin e Arkitekturës, ku po ndërtohet kampusi i ri për studentët. Ambientet e reja do të jenë të pajisura me salla leksionesh, laboratorë, bibliotekë dhe hapësira rekreative, që do t'u shërbejnë studentëve dhe stafit akademik në procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Së bashku me projektuesit dhe pedagogët e fakulteteve, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu inspektoi punimet, që mbështeten në masën 70% nga buxheti i shtetit dhe 30% nga të ardhurat dytësore të Universitetit Politeknik. Gjithashtu Ministria Manastirliu prezantoi në Universitetin e Sporteve investimin më të ri që do të rrisë nivelin sportiv: rindërtimin e fushës së futbollit dhe pistës së atletikës. Të dala jashtë funksionit, këto ambiente do t'u rikthehen sportistëve me standarde bashkëkohore.



Investimet në arsimin parauniversitar

Kryeministri Edi Rama dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu vizituan shkollën e re "Skënder Libohova" në Lushnjë, që ka hapur dyert për më shumë se 600 nxënës që mësojnë në kushte bashkëkohore. Ministria Manastirliu mori pjesë gjithashtu në ceremoninë e përirimit të shkollës dhe kopshtit të ri "Eftali Koçi", të shkollës së re 9-vjeçare "26 Nëntori", investim i programit EU4Schools. Ka përfunduar po ashtu shkolla 9-vjeçare "Demokracia" në Valias dhe janë drejt përfundimit gjimnazi "Pjetër Budi" në Mat, gjimnazi "Naim Frashëri" në Durrës, shkolla "Ibrahim Basa" në Kamëz, "Bernardina Qerraxhia" në Durrës. Një tjetër investim ka nisur në shkollën 9-vjeçare "Naim Frashëri" në Fier që do të ofrojë standarde bashkëkohore për 815 nxënës dhe 44 mësues.

Bashkia e Kamzës firmos marrëveshjen për Kartën e Studentit

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Bashkia e Kamzës firmosën marrëveshjen për Kartën e Studentit. Falë kësaj marrëveshjeje studentët e Universitetit Buqësor të Tiranës, por edhe universiteteve të tjera, përfitojnë shërbime të ndryshme falas ose me çmime të reduktuara, në fushën e transportit publik, aktiviteteve sociale-kulturore dhe sportive etj.

Investimi në Universitetin e Sporteve, pistë e re e atletikës

Ministria e Arsimit dhe Sportit financoi për herë të parë projektin për pistën e re të atletikës në Universitetin e Sporteve. Ky projekt do të përfundojë vitin që vjen dhe sportistët do të kenë pistën e atletikës me 4 korsi dhe fushën e re të futbollit.

KONKURSI KOMBËTAR I GJUHËS SHQIPE, 11 MIJË NXËNËS NË GARË

Mbi 11 mijë nxënës të klasave të 9-ta nga e gjithë Shqipëria nisën në 12 mars Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe. Në fazën e dytë të Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe, i cili u mbyll në 29 mars, 5600 nxënës nga e gjithë Shqipëria përfaqësuan shkollat e tyre, duke sfiduar njëri-tjetrin, me njohuritë dhe aftësitë gjuhësore dhe komunikuese. Ky konkurs po zhvillohet në kuadrin e "Vitet të gjuhës shqipe", përgjatë të cilit do të zhvillohet një kalendar i pasur aktiviteteve, dedikuar gjuhës shqipe dhe synon ndërgjegjësimin e brezit të ri për të mësuar dhe ruajtur gjuhën amtare.



MIRATOHET STATUSI I VEÇANTË PËR SHKOLLAT ME DREJTIM ARTISTIK E SPORTIV

Shkollat e drejtimeve artistike dhe sportive do të marrin status të veçantë. Këshilli i Ministrave miratoi projektvendimin që u jep këtyre shkollave një status që u garanton vazhdimësi dhe mbështetje të talenteve të reja, do të sigurojë rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përmes garantimit të kushteve të punës dhe rritjes profesionale të mësuesve. Falë këtij statusi këto shkolla do të financohen më shumë dhe do të kenë një strukturë organizimi dhe kurrikul të ndryshme nga institucionet arsimore publike parauniversitare.